

**VENDIM****Nr. 920, datë 29.12.2014****PËR MIRATIMIN DHE PUBLIKIMIN
ZYRTAR TË NOMENKLATURËS SË
KOMBINUAR TË MALLRAVE, PËR
VITIN 2015**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1 e 12, të ligjit nr.9461, datë 21.12.2005, “Për nomenklaturën e mallrave dhe tarifën doganore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, 2015,

sipas lidhjes nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr.1067, datë 14.12.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, 2014”, si dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 2015 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama